



REPUBLIKA E KOSOVËS - РЕПУБЛИКА КОСОВО - REPUBLIC OF KOSOVO  
**GJYKATA KUSHTETUESE**  
**УСТАВНИ СУД**  
**CONSTITUTIONAL COURT**

Prishtinë, më 13 gusht 2014  
Nr.ref.:RK697/14

## **AKTVENDIM PËR PAPRANUESHMËRI**

në

**Rastin nr. KI208/13**

Parashtrues

**Rexhep Kabashi**

**Vlerësimi i kushtetutshmërisë së Vendimit të Dhomës së Posaçme të  
Gjykatës Supreme, ACI-13-0094-A0001, të 30 tetorit 2013**

### **GJYKATA KUSHTETUESE E REPUBLIKËS SË KOSOVËS**

e përbërë nga:

Enver Hasani, kryetar  
Ivan Čukalović, zëvendëskryetar  
Robert Carolan, gjyqtar  
Altay Suroy, gjyqtar  
Almiro Rodrigues, gjyqtar  
Snezhana Botusharova, gjyqtare  
Kadri Kryeziu, gjyqtar, dhe  
Arta Rama-Hajrizi, gjyqtare

#### **Parashtruesi i kërkesës**

1. Parashtrues është z. Rexhep Kabashi, Prokuror i Shtetit në Zyrën e Prokurorit të Shtetit (në tekstin e mëtejme: parashtruesi).

## **Vendimi i kontestuar**

2. Parashtruesi ka parashtruar kërkesën në lidhje me rastet e M. J., B. J., T. J., R. J. dhe I. J. dhe konteston Aktvendimin ACI-13-0094-A0001 të Dhomës së Posaçme të Gjykatës Supreme (në tekstin e mëtejme: DHPGJS), të 30 tetorit 2013. Data e dorëzimit të aktvendimit të kontestuar të parashtruesi nuk është e njohur.

## **Objekti i çështjes**

3. Objekt i çështjes është kërkesa për vlerësimin e kushtetutshmërisë së Aktvendimit ACI-13-0094-A0001, të DHPGJS-së, të 30 tetorit 2013. Aktvendimi i lartpërmendur i DHPGJS-së e ka hedhur poshtë si të palejueshme kërkesën për mbrojtje të ligjshmërisë, të parashtruar nga parashtruesi.

## **Baza juridike**

4. Kërkesa është e bazuar në nenin 113.7 të Kushtetutës së Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejme: Kushtetuta), nenit 47 të Ligjit për Gjykatën Kushtetuese të Republikës së Kosovës, Nr. 03/L-121 (në tekstin e mëtejme: Ligji) si dhe në rregullin 56.2 të Rregullores së punës të Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejme: Rregullorja e punës).

## **Procedura në Gjykatë**

5. Më 18 nëntor 2013, parashtruesi e dorëzoi kërkesën në Gjykatën Kushtetuese.
6. Më 3 dhjetor 2013, Kryetari, me Vendimin Nr. GJR. KI208/13, caktoi gjyqtarin Ivan Čukalović gjyqtar raportues. Të njëjtën ditë, Kryetari, me Vendimin Nr. KSH. KI208/13, caktoi Kolegjin shqyrtues të përbërë nga gjyqtarët: Altay Suroy (kryesues), Snezhana Botusharova dhe Arta Rama-Hajrizi.
7. Më 7 shkurt 2014, Gjykata e njoftoi parashtruesin për regjistrimin e kërkesës. Gjykata gjithashtu i kërkoi parashtruesit t'i qartësojë disa aspekte dhe ta plotësojë kërkesën e tij. Të njëjtën ditë, DHPGJS-ja u njoftua për regjistrimin e kërkesës.
8. Më 11 shkurt 2014, parashtruesi e dorëzoi në Gjykatë kërkesën e plotësuar.
9. Më 8 maj 2014, Kolegji shqyrtues pas shqyrtimit të raportit të gjyqtarit raportues, i rekomandoi Gjykatës papranueshmërinë e kërkesës.

## **Përmbledhja e fakteve**

10. Më 9 gusht 2013, parashtruesi kishte parashtruar një kërkesë për mbrojtje të ligjshmërisë në DHPGJS, ndaj Gjykatës Supreme të Kosovës, kundër Aktgjykimit të Gjykatës Komunale në Prishtinë, C. nr. 1738/2007, të 19 korrikut 2007, Aktvendimit të trupit gjyqës të DHPGJS-së, SCA-08-0041, të 27 dhjetorit 2011, si dhe të Aktvendimit të Kolegjit të Ankesave të DHPGJS-së, AC-

I-12-0055, të 30 prillit 2013, duke pretenduar që këto vendime të lartpërmendura janë marrë me shkelje të dispozitave ligjore.

11. DHPGJS-ja konsideron që:

*“Kolegji i ankesave konsideron që në bazë të nenit 10, paragrafi 14 të Ligjit nr. 04/l-033 për Dhomën e Posaçme të Gjykatës Supreme për çështjet që kanë të bëjnë me Agjencinë Kosovare të Privatizimit (DHP), të gjitha aktgjykimet dhe aktvendimet e Dhomës së Posaçme janë të prera dhe të plotfuqishme dhe nuk i nënshtrohen ankesës. Përveç kësaj, Ligji për Dhomën e Posaçme dhe Shtojca e tij nuk ofrojnë mjete të tjera juridike të jashtëzakonshme kundër atyre aktgjykimeve apo aktvendimeve të Kolegjit të Ankesave (mjete të jashtëzakonshme nuk parashihen as me Rregulloren e UNMIK-ut 2008/4 e as me Urdhëresën Administrative të UNMIK-ut 2008/6)”*

12. Për më tepër, DHPGJS-ja konsideron që:

*“Kërkesa për mbrojtje të ligjshmërisë, e parashtruar nga Prokurori i Shtetit sipas dispozitave të Ligjit për Procedurën Kontestimore (LPK) në emër të një pale mund të vlejë si mjet i jashtëzakonshëm juridik kundër një vendimi të prerë të gjykatave të instancës më të ulët, por jo kundër një vendimi përfundimtar të Kolegjit të Ankesave të DHPGJS-së, sepse siç u përmend më lart, neni 10.14 i Ligjit e parandalon këtë mundësi”*

[...]

*“Kështu, kërkesa për mbrojtje të ligjshmërisë, si mjet i jashtëzakonshëm, nuk mund të parashtrohet kundër atyre vendimeve, dhe si e tillë, u hodh poshtë si e palejueshme”*

### **Pretendimet e parashtruesit**

13. Parashtruesi pretendon që aktvendimi i DHPGJS-së është marrë me shkelje të dispozitave të Kushtetutës:

*“- Shkeljes së dispozitës së nenit 31 të Kushtetutës së Republikës së Kosovës dhe lidhur me nenin 6 dhe 13 të Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut për gjykim të drejtë dhe të paanshëm;*

*- Shkeljeve të dispozitës së nenit 32 të Kushtetutës së Republikës së Kosovës e drejta për mjete juridike si dhe lidhur me nenin 8 të Deklaratës Universale mbi të Drejtat e Njeriut; dhe*

*- Shkeljës së dispozitës së nenit 24 të Kushtetutës së Republikës së Kosovës barazia para ligjit dhe lidhur me nenin 7 të Deklaratës Universale mbi të drejtat e njeriut”*

14. Në këtë drejtim, parashtruesi kërkon si në vijim:

*“Aktvendimi i Kolegjit të Apelit të Dhomës së Posaçme të Gjykatës Supreme të Kosovës, për çështjet që lidhen me Agjencinë Kosovare të Privatizimit ACI.-13-0094A0001 të dt. 30.10.2013 të prishet (anulohet) dhe Kolegji i*

*Apelit i kësaj Dhome të detyrohet që Kërkesën e Prokurorit të Shtetit për mbrojtje të ligjshmërisë KMLC. nr. 58/2011 të dt. 25.06.2013 të paraqitur për Gjykatën Supreme të Kosovës kundër aktgjykimit të fuqisë së prerë të Gjykatës Komunale në Prishtinë C. nr. 738/2007 të dt. 19.11.2007 aktvendimit të Dhomës së Posaçme të Gjykatës Supreme të Kosovës, për çështjet që lidhen me Agjencinë Kosovare të Privatizimit SCA-08-0041 të dt. 27.12.2012 dhe kundër aktvendimit të po të njëjtës gjykatë AC-I-12-0055 të dt.30.04.2013 T'IA DORËZUJ Gjykatës Supreme të Kosovës si gjykatë ekskluzivisht kompetente për të vendosur për mjetet e jashtëzakonshme juridike”.*

15. Në lidhje me kriteret e pranueshmërisë, parashtruesi pretendon si në vijim:

*“Prokurori i Shtetit në Zyrën e Kryeprokurorit të Shtetit të Republikës së Kosovës në kuptim të dispozitës së nenit 113 par.7 dhe lidhur me nenin 21.4 të Kushtetutës së Republikës së Kosovës pretendon se e ka të drejtën t'i drejtohet Gjykatës Kushtetuese me kërkesë për të vlerësuar ligjshmërinë e vendimit të Kolegjit të Apelit të Dhomës së Posaçme të Gjykatës Supreme të Kosovës për çështjet që lidhen me Agjencinë Kosovare të Privatizimit ACI-13-0094-A-001 të dt. 30.10.2013, nga vet fakti se Prokurori i Shtetit është autoriteti i vetëm ligjor me ligj i autorizuar i cili në kuptim të dispozitave të nenit 245 të LPK-së (Ligji nr.03-L-0006 i dt.30.06.2008 ) ngrit kërkesë për mbrojtje të ligjshmërisë kundër vendimeve gjyqësore të formës së prerë me të cilat vendime janë shkelur të drejtat dhe liritë themelore të palëve dhe në rastin konkret kemi të bëjmë me shkelje të liritë dhe të drejtave të palës së paditur KBI (Kosova Export) në Fushë-Kosovë, të drejtat dhe interesat e të së cilëve i mbron Prokurori i Shtetit, pasi qe palët nuk e kanë një të drejtë të këtillë. Ne rastin konkret Prokurori i Shtetit duke i mbrojtur të drejtat dhe interesat e palëve, e ka cilësinë e palës procedurale me ligj në kuptim të dispozitës së nenit 73.1 dhe 73.2 të LPK-së. Atëherë, në qoftë se Prokurori i Shtetit është palë në procedure, në kuptim të dispozitave të nenit 113 par.7 dhe lidhur me nenin 21.4 të Kushtetutës e ka të drejtën që në Gjykatën Kushtetuese të Kosovës të ngre çështjet e ligjshmërisë së vendimeve gjyqësore të formës së prerë”.*

### **Pranueshmëria e kërkesës**

16. Gjykata vëren se, për të gjykuar ankesën e parashtruesit, është e domosdoshme të vlerësojë nëse ai i ka plotësuar kërkesat e pranueshmërisë, të përcaktuara me Kushtetutë si dhe të specifikuara më tutje me Ligj dhe me Rregullore të punës.
17. Në këtë drejtim, Gjykata i referohet nenit 113.1 të Kushtetutës, i cili përcakton:
- “Gjykata Kushtetuese vendos vetëm për rastet e ngritura para gjykatës në mënyrë ligjore nga pala e autorizuar”.*
18. Gjykata gjithashtu i referohet rregullit 36 (3) c) të Rregullores së punës:
- “Po ashtu, një kërkesë mund të konsiderohet si e papranueshme edhe në rastet vijuese, kur:*

[...]

*c) kërkesa parashtrohet nga një palë e paautorizuar”.*

19. Kështu, Gjykata konsideron që së pari duhet të përcaktojë nëse parashtruesi është palë e autorizuar në kuptimin e dispozitave ligjore të përmendura më lart.
20. Në këtë drejtim, Gjykata Kushtetuese vëren se parashtruesi e ka dorëzuar kërkesën në lidhje me rastet e M. J., B. J., T. J., R. J. dhe I. J. kundër Aktgjykimit të Gjykatës Komunale në Prishtinë, C. nr. 1738/2007, të 19 korrikut 2007, aktvendimeve të trupit gjykues të DHPGJS-së, SCA-08-0041, të 27 dhjetorit 2011, si dhe të Kolegjit të Ankesave të DHPGJS-së, AC-I-12-0055, të 30 prillit 2013.
21. Në rastin konkret, parashtruesi ka theksuar në lidhje me kërkesën, inter alia:

[...]

*“Prokurori i Shtetit në Zyrën e Kryeprokurorit të Shtetit të Republikës së Kosovës në kuptim të dispozitës së nenit 113 par.7 dhe lidhur me nenin 21.4 të Kushtetutës së Republikës së Kosovës pretendon se e ka të drejtën t'i drejtohet Gjykatës Kushtetuese me kërkesë për të vlerësuar ligjshmërinë e vendimit të Kolegjit të Apelit të Dhomës së Posaçme të Gjykatës Supreme të Kosovës për çështjet që lidhen me Agjencinë Kosovare të Privatizimit ACI-13-0094-A-001 të dt. 30.10.2013, nga vet fakti se Prokurori i Shtetit është autoriteti i vetëm ligjor me ligj i autorizuar i cili në kuptim të dispozitave të nenit 245 të LPK-së (Ligji nr.03-L-0006 i dt.30.06.2008 ) ngrit kërkesë për mbrojtje të ligjshmërisë kundër vendimeve gjyqësore të formës së prerë...”.*

22. Mirëpo, pasi një individ mund të parashtrojë kërkesë në Gjykatë, neni 113.7 përcakton që:

*“Individët janë të autorizuar të ngrenë shkeljet nga autoritetet publike të të drejtave dhe lirive të tyre individuale, të garantuara me Kushtetutë, mirëpo vetëm pasi të kenë shteruar të gjitha mjetet juridike të përcaktuara me ligj”.*

23. Gjykata konsideron se nuk duket që të ketë ndonjë arsye pse M. J., B. J., T. J., R. J. dhe I. J. nuk kanë mundur të parashtrojnë kërkesë në këtë gjykatë në emrin e tyre, pas shterimit të të gjitha mjeteve juridike dhe brenda afatit prej 4 (katër) muajve, nga data në të cilën janë dorëzuar aktvendimet e Kolegjit të Ankesave të DHPGJS-së. Individët kanë të drejtë të parashtrojnë kërkesë në këtë gjykatë, pa ndërmjetësim të palëve të treta, sipas kushteve të nenit 113.7 të Kushtetutës.
24. Andaj, Gjykata konsideron që kërkesa nuk është parashtruar në mënyrë të ligjshme, si dhe që parashtruesi nuk është palë e autorizuar sipas kushteve të përcaktuara me nenin 113, paragrafët 1 dhe 7 të Kushtetutës.

## PËR KËTO ARSYE

Gjykata Kushtetuese e Kosovës, në pajtim me nenin 113.1 dhe 113.7 të Kushtetutës, dhe me rregullin 56 (2) b) të Rregullores së punës, në Seancën e mbajtur më 8 maj 2014, njëzëri

### VENDOS

- I. TA DEKLAROJË kërkesën të papranueshme;
- II. T'UA KUMTOJË këtë vendim palëve dhe ta publikojë në Gazetën Zyrtare, në pajtim me nenin 20. 4 të Ligjit;
- III. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

**Gjyqtari raportues**



Ivan Čukalović



**Kryetari i Gjykatës Kushtetuese**



Prof. dr. Enver Hasani